

RAPORT PROGRESIV PËR RASTIN E CAO-S SHQIPËRI – ANKESA PËR BANKERS PETROLEUM Maj 2016

Mandati i CAO-s

Zyra e Avokatit të Ankesave, Këshilltarit dhe Përputhshmërisë (CAO) është një zyrë e pavarur që raporton drejtpërdrejt te Presidenti i Grupit të Bankës Botërore. Mandati i CAO-s është të adresojë ankesat e njerëzve që preken nga projektet e financuara nga Korporata Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencia për Garancinë e Investimeve Shumëpalëshe (MIGA), në një mënyrë të drejtë, objektive dhe konstruktive dhe të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të projekteve në të cilët kanë rol këto institucione.

Ankesa

Në mars të vitit 2013, CAO mori një ankesë për projektin e Bankers Petroleum Ltd. (Bankers) në Shqipëri të financuar nga IFC-ja. Ankesa u depozitua nga një ambientalist nga Shqipëria, në emër të banorëve nga komuna Zharrëz (Patos) në Shqipëri. Në ankesë ngrihen shqetësime rreth impaktit të shkaktuar në komunitet nga teknikat e nxjerrjes të përdorura nga Bankers në fushën naftëmbajtëse të Patos-Marinzës, dhe vë në dyshim përputhshmërinë me Standardet e Performancës së IFC-së. Në ankesë thuhet se teknikat e shpimit dhe të prodhimit mund të jenë përgjegjëse për tërmetet dhe lëvizjet e tjera të tokës, të cilat po shkaktojnë çarje të ndërtesave dhe po dëmtojnë rrjetet lokale të vaditjes.

Vlerësimi nga CAO dhe Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve

Në vijim të vlerësimit të bërë nga CAO në vitin 2013, palët – anëtarë të komunitetit dhe Bankers, ranë dakord të përfshiheshin në një proces dialogu të lehtësuar nga CAO dhe të eksploronin mundësi për një proces hulumtues të përbashkët për të adresuar shqetësimet në lidhje me aktivitetin sizmik në afërsi të Zharrzës dhe çështje të tjera sociale dhe mjedisore me një spektër më të gjerë në zonat përreth fushës naftëmbajtëse të Patos-Marinzës. Para se të fillonte angazhimi në një proces formal, grupi i CAO-s punoi ngushtë me anëtarë të komunitetit dhe drejtues lokalë për të identifikuar përfaqësues të respektuar për të marrë pjesë në proces. Pas identifikimit të përfaqësuesve të grupit të dialogut, grupi i CAO-s organizoi një workshop për rritjen e kapaciteteve në fushën e negociimit të bazuar te interesat, komunikimit efektiv, parimeve të ndërmjetësimit dhe zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve. Në workshop u prezantuan dhe rregullat bazë për dialogun. Modeli i workshop-it është përsëritur edhe dy herë të tjera për anëtarët e rinj të përfshirë në Grupin e Dialogut.

Fig 1: Përfaqësues të komunitetit dhe të kompanisë gjatë një takimi të përbashkët



Sipas marrëveshjes së arritur bashkërisht në takimin e Dhjetorit 2014, Grupi i Dialogut përbëhet nga drejtues dhe pjesëtarë të stafit të Bankers dhe përfaqësues nga katër komunitetet e prekura. U formuan tre nën-grupe pune të Grupit të Dialogut, të cilët u fokusuan në tri tema të rëndësishme të identifikuara nga palët: 1) Tërmetet, 2) Investimet dhe Çështjet Sociale dhe 3) Mjedisi. Në janar 2015, këto grupe pune filluan të takohen çdo muaj për të rënë dakord dhe për të diskutuar për çështje specifike. Në gjashtë muajt e parë të takimeve të grupeve të punës, pjesëmarrësit u fokusuan në shkëmbimin e informacionit dhe për të mësuar për çështjet, shqetësimet dhe standardet rregullatorë. Në fazën e dytë të procesit, e cila filloi në qershor 2015, grupet e punës identifikuan çështjet kryesore për t'u negociuar dhe strategjitë për zbatimin e zgjidhjeve praktike dhe planeve të punës. Si rezultat i këtij procesi kompleks, palët identifikuan 33 çështje që lidhen me lëvizjet e tokës (8 çështje), mjedisi (9 çështje) dhe investimet sociale (16 çështje). Grupi i Punës për Tërmetet dhe Grupi i Punës për Mjedisin janë bashkuar në një grup, Grupi i Punës për Tërmetet dhe Mjedisin, për të ofruar një proces më efektiv dhe për të shmangur mbivendosjen e përpjekjeve.

Si pjesë e procesit të dialogut, Bankers instaloi 2 sizmometra për t'i paraqitur komunitetit informacion kyç në lidhje me natyrën dhe thellësinë e tërmeteve pranë fushës naftëmbajtëse dhe për t'u japë mundësinë për të identifikuar bashkërisht zgjidhje. Në vijim, palët iu drejtuan me një letër të përbashkët drejtuesve të institucioneve të nivelit të lartë duke kërkuar informacione në lidhje me instalimin dhe transmetimin e të dhënave në rrjetin sizmik kombëtar. Marrëveshja midis BPAL dhe institucioneve shtetërore përkatëse për lidhjen e sizmometrave do të zbatohet brenda afatit të mundshëm.

Fig 2: Një përfaqësues i kompanisë duke prezantuar për pjesëmarrësit e tryezës së dialogut



Marrëveshje të tjera të arritura deri tani në këtë proces përfshijnë:

- Marrëveshje për të kryer një studim për aktivitetin sizmik në rajon
- Përmirësime të cilësisë së ajrit në zonë
- Mundësi punësimi për banorët
- Investimet sociale



OFFICE OF THE COMPLIANCE ADVISOR/OMBUDSMAN
2121 PENNSYLVANIA AVENUE, NW • WASHINGTON, DC 20433, USA
TELEPHONE (202) 458-9452 • FACSIMILE (202) 522-7400

Ajo që është më e rëndësishmja, është se një progres i arritur është krijimi i respektit dhe besimit reciprok midis përfaqësuesve, gjë që ka bërë të mundur arritjen e marrëveshjeve përmes procesit të dialogut.

Në lidhje me mbylljen eventuale të çështjes, palët kanë rënë dakord për një proces ku marrëveshjet e përfunduara të kalojnë në fazën e monitorimit. Në këtë mënyrë procesi siguron zbatimin adekuat të marrëveshjeve të ndryshme, të vijuar nga mbyllja e çështjes pas zgjidhjes së kënaqshme.

Ky raport dhe rezultatet specifike të procesit, të përmbledhura në Aneksin 1 dhe 2, janë miratuar nga palët në takimet e grupeve të punës të mbajtura gjatë muajit Maj 2016 (18 Maj për Grupin e Punës për Tërmetet dhe Mjedisin dhe 20 Maj për Grupin e Punës për Çështjet Sociale dhe të Investimeve).

Procesi i Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, i drejtuar nga CAO, është në vazhdim dhe për më shumë informacion, ju lutem referojuni - http://www.cao-ombudsman.org/cases/case_detail.aspx?id=197 dhe dokumenteve përkatëse <http://www.cao-ombudsman.org/cases/document-links/links-197.aspx>.

Aneks 1

Grupi i Punës për Tërmetet dhe Mjedisin

Në mars 2013 në Zyrën e CAO-s u depozitua një ankesë në lidhje me Projektin e Bankers Petroleum (Projekti i IFC-së #27306). Në ankesë ngrihen pretendime se operacionet e kompanisë kanë shkaktuar impakte negative në shëndet, aksidente, ndotje të sistemit të vaditjes, dhe se lëkundjet sizmike kanë dëmtuar shtëpitë dhe ndërtesat e tyre. Në terma më të përgjithshëm, ankuesit ngrenë shqetësime për impaktin nga nxjerrja e naftës dhe gazit në zonën e tyre dhe për rreziqet potenciale për komunitetin dhe mjedisin.

Gjatë periudhës Maj-Gusht 2013 u bë një vlerësim i ankesës. Bazuar në intervistat e bëra gjatë fazës së vlerësimit nga CAO, u vendos që çështja kryesore për t'u adresuar gjatë procesit të CAO-s ishte shkaku i tërmeteve në zonën e Patos-Marinzës. Pati një marrëveshje të gjerë nga banorët e Zharrëzës, përfaqësuesit e BPAL dhe përfaqësuesit e sektorit publik që kjo pyetje mund të merre një përgjigje më përfundimtare përmes një informacioni më të thelluar dhe të besueshëm teknik. Pati gjithashtu marrëveshje se një 'hetim' i tillë duhet të planifikohet në bashkëpunim dhe duhet të përfshinte ekspertë të pavarur e të besueshëm, të specializuar në fushën e semiologjisë në kontekstin e projekteve të naftës dhe gazit.

U propozuan veprime të ndryshme, investime dhe studime për t'u dhënë mundësi palëve që përmes procesit të shkohet drejt zgjidhjes dhe mbylljes së ankesës. U ngrit një grup dialogu. Çështjet kryesore që trajtohen aktualisht janë parashtuar më poshtë. Për çdo takim të grupit të dialogut janë mbajtur minutat e takimit, për t'u referuar për informacione shtesë.

| Kategoria | Veprimi | Statusi i veprimit | Statusi |
|--|--|---|---------|
| Instalimi dhe vënia në punë e sizmometrave | Të instalohen sizmometra në terren në konsultim me palët përkatëse të interesit dhe ekspertë | Të blerë dhe të instaluar – Përfunduar 2013 | ÇZ |
| | Të blihen kompjuterët / programet kompjuterike dhe pajisje të tjera të kërkuara | Të blerë nga Bankers – Përfunduar 2013 | ÇZ |
| | Të firmoset marrëveshje midis BPAL-Qeverisë për të lidhur sizmometrat me rrjetin kombëtar; të analizohen dhe të interpretohen të dhënat sizmike; të informohet grupi i punës për rezultatet e këtij investigimi. | Bankers do të bashkëpunojë me Institutin e Gjeoshkencës për lidhjen e sizmometrave me rrjetin kombëtar. | NM |
| Studimi shkencor për aktivitetin sizmik | Të identifikohet dhe të kontraktohet një ekspert për të cilin të bihet dakord, i cili të ketë ekspertizën e duhur për të bërë një vlerësim të pavarur. | BPAL ka kontraktuar një profesor nga Universiteti "Aristoteli" i Selanikut për të kryer një studim për historikun dhe trendin e lëkundjeve në rajon. Faza I e punës ka filluar dhe BPAL është e vendosur për ta mbështetur, financuar këtë proces. | NM |
| | | - Përfaqësuesit e komunitetit mund të ndërmarrin veprime, si rishikimin e studimit me ekspertë të tjerë (p.sh. ekspertë shqiptarë); - CAO ka shpërndarë për përfaqësuesit e komunitetit Termat e Referencës në lidhje me studimin rreth historikut dhe trendit të lëkundjeve në rajon. | PZ |
| | | | ÇZ |



| Kategoria | Veprimi | Statusi i veprimit | Statusi |
|--|--|---|---------|
| | Rishikimi i të dhënave sizmike | Profesori nga Universiteti "Aristoteli" i Selanikut do të shqyrtojë të dhënat sizmike kur ato të jenë të disponueshme, pasi ai të ketë përfunduar fazën I të studimit të tij. Ky veprim varet nga marrëveshja nga institucione qeveritare në mënyrë që të grumbullohen të dhënat që transmetohen aktualisht nga sizmometrat. | PZ |
| | Përfaqësuesit e komunitetit kërkojnë një studim më të gjerë gjeologjik për impaktin afatgjatë të operacioneve të Bankers. | - BPAL sugjeroi që arritja e këtij qëllimi duhet të shikohet në termin afatgjatë, pasi si pari do të nevojitet një analizë teknike e brendshme teknike shumëdisiplinare. | PZ |
| Informacion operacion | Bankers ofron të prezantojë informacion dhe dokumentacion në lidhje me teknologjinë që përdor në operacionet e saj (duke përfshirë teknikat e nxjerrjes dhe të shkarkimit të ujit). Komuniteti mund të kërkojë ndihmën e një pale të tretë (eksperti) për të shpjeguar dokumentacionin. | BPAL ofroi informacion për operacionet e saj në një vizitë në terren që u organizua për anëtarët e grupit të punës më 21 Nëntor. BPAL ofroi dhe ekspertë teknike për të prezantuar për Grupin e Dialogut. BPAL ofroi për Grupin e Dialogut prezantim nga ekspertë teknikë. - Përfaqësuesit e komunitetit: do të kërkojnë një vlerësim nga një palë e tretë. | PZ |
| | Identifikimi i një eksperti për të bërë një vlerësim të pavarur për operacionet e BPAL dhe për të dhënë një opinion nëse BPAL shkakton lëkundjet e tokës. Identifikimi i ekspertit duhet të bazohet në Termat e Referencës dhe të zgjidhet nga të gjithë anëtarët e grupit të punës. (BPAL u sugjeroi pjesëmarrësve të identifikonin një ekspert ndërkombëtar me eksperiencë në këtë lloj teknologjie specifike që përdor BPAL). | - Pjesëmarrësit shprehin vullnetin për të kërkuar një ekspert të pavarur. U sugjerua që CAO të ofrojë mbështetje në këtë drejtim. | PZ |
| Aktivitete/veprim e të tjera mbështetëse | Bankers ofron të kontrakttojë një inxhinier nga Italia për t'u konsultuar me komunitetet për ndërtimin e shtëpive në zona sizmike. | - BPAL ofron këtë mundësi për komunitetin si dhe një vlerë e shtuar për procesin e dialogut; - Pjesa më e madhe e përfaqësuesve të komunitetit ishin në favor të idesë. | PZ |

Legjenda:

- "Statusi i çështjes" (1(PZ)) Proces zgjidhjeje; (2(NM)) Nën monitorim; (3(ÇZ)) Çështje e zgjidhur; (4(TA)) Transferuar për audit
- Lista 1/2: Lista 1: Çështje që janë të negociueshme midis komunitetit dhe kompanisë; Lista 2: Çështje për të cilat nevojitet përfshirja e aktorëve të tjerë në negociim (p.sh. pushteti vendor, institucione të tjera shtetërore).



Grupi i Punës për Tërmetet dhe Mjedisin

Dialogu i zgjeruar

Përveç grupit të dialogut për ankesën fillestare, CAO ka lehtësuar një proces të strukturuar për të diskutuar një numër çështjesh të cilat janë me interes për komunitetet rreth zonës së Patos-Marinzës. Temat, dhe në pjesën më të madhe, komunitetet dhe individët janë jashtë fushës së ankesës fillestare.

Dialogu për mjedisin

| <i>Kategoria</i> | <i>Veprimi</i> | <i>Statusi i veprimit</i> |
|---------------------|--|--|
| Monitorimi mjedisor | Bankers ofron të paraqesë raporte monitoruese. | Përfunduar në 2015. Duke përfshirë prezantimin e të dhënave për Grupin e Dialogut. |
| | Përgatitja dhe fillimi i një programi monitorues gjithëpërfshirës, me pjesëmarrjen e banorëve, specialistëve të kompanisë dhe ekspertëve të jashtëm të fushës. | 7 persona të identifikuar, u trajnuan për H2S-në, u ftuan të merrnin pjesë në marrjen e kampioneve; u njohën me prezantimin nga laboratorit i Akredituar nga Mbretëria e Bashkuar për analizat e kampioneve QA/QC. Për tremujorin e parë – Monitorimi me pjesëmarrje i përfunduar; për tremujorin e dytë është në vazhdim. |
| Cilësia e ajrit | Ndërmarrja e hapave për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe për t'u siguruar që mjedisi nuk po shkakton problem mjedisorë. | 1. BPAL të vazhdojë programin për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe për mbledhjen e gazit. 2. BPAL ka prezantuar informacion për Grupin e Dialogut rreth programeve për përmirësimin të cilësisë së ajrit dhe mbledhjen e gazit. Kjo mund të lidhet me Veprimin 1 dhe grupi monitorues mund të ndajë informacion pas çdo faze. 3. BPAL ka prezantuar Raportin Mjedisor /2015 dhe Planin Mjedisor/2016 në takimin e grupit të punës në Janar 2016. |
| | Të përfundohen projektet e kapjes së gazit dhe të tubacionit, e dhe rënia dakord për hapat e mëtejshëm: Angazhimi i BPAL (Shkurt 2015): - Infrastruktura për mbledhjen e gazit në Satelitin 3 në Belinë do të instalohet brenda një muaji. - Një tjetër aparaturë për mbledhjen e gazit do të instalohet para Qendrës së Dekantimit. Kjo do të përmirësojë cilësinë e ajrit në afërsi në Qendrës së Dekantimit, pasi nafta dhe gazi grumbullohen atje, dhe mundësia për çlirime në atmosferë është më e madhe, pasi aty përdoren dhe diluentë në procesin e dekantimit. - Projekti për shtrimin e tubacionit të naftës në zonën veriperëndimore (Kallm dhe Belinë) do të përfundojë në shtator 2015. | Tubacioni i naftës- Përfunduar Sat 3 Përfunduar Pad H Përfunduar Pad D Në vazhdim CTF (Qendra e Dekantimit) – Koha për t'u vendosur |
| | Të diskutohen strategji të tjera që mund të ndërmarrë kompania dhe Grupi i Dialogut për të përmirësuar cilësinë e ajrit dhe për të pakësuar ndotjen industriale. | Kompania po merr parasysh një uzinë gazi. |



| <i>Kategoria</i> | <i>Veprimi</i> | <i>Statusi i veprimit</i> |
|-----------------------------------|--|---|
| | Të diskutohet dhe të bihet dakord për strategjitë për asfaltimin e rrugëve ku kalojnë rregullisht makinat e BPAL, për të pakësuar ndotjen dhe pluhurin në këto zona. | Kompania do të vijojë të minimizojë përdorimin e kamionëve, instalimin e tubacionit, lagjen me ujë, shtrimin me rërë të prodhuar ku të jetë e mundshme. Sidoqoftë, projektet infrastrukturore janë përgjegjësi e pushtetit vendor/qendror. |
| Siguria | Eksplorimi i mundësive për zhvendosjen e familjeve që jetojnë shumë pranë puseve për të garantuar sigurinë e tyre. | Bankers siguron sigurinë e familjeve që jetojnë afër puseve përmes praktikave të mira operacionale dhe teknologjisë. Kompania ka një Plan efektiv për Përgjigjen ndaj Emergjencave dhe respekton të gjitha distancat e parashikuara nga ligji. |
| Riciklimi / Pastrimi i mbetjeve | Të zbatohet një plan për konkret për programin e riciklimit/pastrimit në komunitet të mbështetur nga BPAL. | Bankers ofruar të mbështesë një program për pastrimin përmes sigurimit të koshave dhe për të punuar me kontraktorë për të mundësuar mbledhjen. BPAL ka kërkuar për një plan të zbatueshëm nga komunitetet l cili mund të çohet më tej nga grupi. |
| Rehabilitimi i gropave ekologjike | Pastrimi Të diskutohen dhe të arrihet marrëveshje për hapat konkretë për adresimin e çështjes së gropave ekologjike, në bashkëpunim ose jo me institucionet shtetërore, duke përfshirë: - Strategjitë për zhvendosjen e njerëzve që jetojnë kaq pranë gropave ekologjike, ose për garantimin e sigurisë së tyre për të eliminuar rrezikun dhe aromën e keqe. - Strategjitë për të përfshirë qeverinë në pastrimin e gropave ekologjike dhe zhvendosjen e mundshme ose masa të tjera për të garantuar sigurinë e banorëve. - Të vihen në dispozicion të anëtarëve të komunitetit raporte për monitorimin e gropave ekologjike. | Gropa ekologjike 5 po rehabilitohet aktualisht. Janë zbatuar të gjitha lejet; nuk janë identifikuar të dhëna për çështje sigurie në lidhur me gropat ekologjike; Kompania nuk ka plane për të zhvendosur njerëzit. |
| | Komuniteti do të donte që gazi për përdorëj për ngrohjen e shtëpive e ndërtesave. | Ofrimi i gazit do të ishte në kundërshtim me marrëveshjen me qeverinë dhe si rrjedhojë do të ishte i paligjshëm. Për më tepër gazi nga shumë puse është i thartë dhe i rrezikshëm. Kjo kërkesë nuk mund të plotësohet. |

Aneks 2

Grupi i Punës për Çështjet Sociale dhe Investimet

Përmbledhje e Arritjeve të Dialogut për Çështjet Sociale dhe të Investimeve

Marrëveshjet e arritura

| Kategoria | Veprimet/Nevojat | Statusi i Veprimit | Statusi |
|-------------------------------------|--|---|---------|
| Burimet Njerëzore | Praktika mësimore për studentët lokalë që studiojnë në fushën e naftës dhe gazit apo në fusha të ngjashme, dhe mundësisht t'i punësojë ata më pas. | BPAL do të koordinojë me Fakultetin e Inxhinierisë dhe Minierave rreth praktikave mësimore. BPAL është e hapur për marrëveshje të tilla dhe me fakultete të tjera. Kjo do të organizohet çdo vit. | NM |
| | Rishikimi i kontratave me nënkontraktorët (për çështjen e punësimit të banorëve). | Bankers ka përfshirë një dispozitë në kontratat me nënkontraktorët ku konstatohet "nën kushte të barabarta, banorët vendas do të kenë përparësi në punësim". Bankers do të ndajë rregullisht informacion dhe statistika me komunitetin në lidhje me punësimin nga BPAL të banorëve vendas. | ÇZ |
| | Shqyrtimi i mundësive për punësimin e teknikëve të naftës dhe gazit, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm. | BPAL është e angazhuar për të mbështetur çdo iniciativë nga autoritetet arsimore të shtetit në lidhje me krijimin e një programi trajnimi për teknikët vendas të naftës dhe gazit. Priten dhe kontribute nga komuniteti. Rregullisht | NM |
| | Përdorimi i medias sociale për të shpallur vendet e lira pune. | Dy takime janë fokusuar në dhënien e informacionit nga BPAL për politikën e punësimit dhe praktikën e marrjes në punë. Veprime të mundshme që mund të ndërmerren: - BPAL të përdorë mjete të ndryshme (zyrën rajonale të punësimit, website-in, median sociale) për të shpallur mundësitë e punësimit. - BPAL të informojë në lidhje me mjetet/kanalet që përdor për të shpallur vendet vakante. | ÇZ |
| Programi i Investimeve në Komunitet | BPAL ofron të prezantojë rezultatet e anketës për prioritetet e investimeve. Organizimi i takimeve për të diskutuar gjetjet e anketimit me tri grupe të ndryshme: burra, gra, dhe të rinj. Grupet nuk duhet të jenë më shumë se 15 persona. | Në total janë organizuar 15 takime me burra, gra dhe të rinj të fshatrave Belinë, Marinëz, Zharrëz, Sheqishte dhe Kallm i Madh, ku janë prezantuar anketat e bëra për secilin fshat. Përfunduar Tetor-Nëntor 2015. | ÇZ |
| | Ndarja e zonës industriale nga zona e banuar me një resht me pemë, duke ndikuar në përmirësimin e cilësisë së ajrit | Palët ranë dakord që BPAL të mbjellë 1000 rrënjë të pemë paulania deri në Mars 2016. Është rënë dakord nga pjesëmarrësit për hartën e mbjelljes së pemëve. Pemët po mbillen në tokë publike, në anë të vendeve ku operon BPAL. Përfunduar Dhjetor 2015 – Shkurt/Mars 2016 Grup monitorues i përbashkët për të parë numrin e pemëve të mbjella, të pemëve që mungojnë, etj. | NM |
| | Të diskutohet dhe të bihet dakord për strategji për të zgjidhur çështjen e ujit në Marinëz: Të arrihet marrëveshje për hapat konkretë që do të ndërmarrë BPAL | Në vijim të Memorandumit të Mirëkuptimi, BPAL dhe bashkia Roskovec ranë dakord për të punuar së bashku për të arritur objektivat lidhur me studimin e fizibilitetit për Projektin e furnizimit me ujë të Marinëzes. BAPL ofron fonde për studimin dhe pjesën inxhinierike të projektit ndërsa bashkia mbikëqyr aktivitetet dhe siguron lejet përkatëse. Palët kane rënë dakord të përfshijnë një ekspert në hartimin dhe zhvillimin e projektit në fazën studimore. Studimi i para-fizibilitetit ka | NM |



| | | | |
|--|---|---|----|
| | <p>për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së ujit përmes programit të investimeve në komunitet, dhe për rolin që mund të luajnë anëtarët e komunitetit në këtë përpjekje.</p> <p>BPAL të kontraktojë një kompani hidro-teknike për të bërë një vlerësim të sistemit të ujësjellësit, dhe do të identifikojë mënyra për të mbështetur dhe zgjidhur çështjen e furnizimit të komunitetit me ujë.</p> | <p>përfunduar, kontrata me palën e trete është firmosur dhe financimi është siguruar.</p> <p>Koha e zbatimit: Tetor 2015- Nëntor 2016.</p> | |
| | <p>Të sigurohet ngrohje për shtatë shkollë në zonën ku operon BPAL.</p> | <p>Pas negociemeve midis anëtarëve të komunitetit dhe kompanisë, BPAL siguroi mbështetje për ngrohje për shtatë shkolla për 2 muaj.</p> <p>Përfunduar: Shkurt 2016.</p> | ÇZ |

Marrëveshje/Çështje në diskutim

| Kategoria | Veprimet/Nevojat | Statusi i Veprimit |
|-------------------------------------|---|--|
| Burimet Njerëzore | Organizimi i kurseve profesionale për të rinjtë nga komuniteti ku operon kompania për të rritur aftësitë e tyre në fushën e naftës. | BPAL ka prezantuar informacion për kurset profesionale të ofruar nga kompania gjatë dy viteve të fundit, si kurset e gjuhës, dhe programe të tjerë, duke prezantuar të dhënat për numrin e përfituesve. Po zbatohet një proces për vlerësimin e nevojave, i cili nevojitet para se të ndërmerren angazhime. |
| Programi i Investimeve në Komunitet | Diskutim i propozimeve konkrete për sistemin e ujit të pijshëm në Kallm. | Nevojitet një proces i përbashkët për analizimin e situatës për të vlerësuar gjendjen aktuale të sistemit para se të bëhen ndërhyrje të mundshme. |
| | Të eksplorohehen mundësi se si BPAL mund të krijojë më shumë biznese sociale. | BPAL do të krijojë një proces për mbështetjen e bizneseve sociale si: krijimi i një call center në partneritet me pushtetin vendor; ose krijimi i një strukture permanente (OJQ, ose strukturë tjetër) për të siguruar grante të vogla për biznesin lokal. BPA mund ta mbështesë procesin. |
| | BPAL ofron të krijojë grupe prej 3-4 personash të kualifikuar nga secili komunitet, dhe t'i mbështesë financiarisht për të hartuar projekte cilësore që mund t'i drejtohen qeverisë për financim – në përputhje me detyrimin e shtetit për financime për zonat e prekura. | BPAL do të mbështesë krijimin e një programi permanent të komunitetit për të identifikuar mundësi financuese dhe shkrimin e projekt-propozimeve. Për këtë do të nevojitet dhe mendimi i pushtetit vendor. BPAL mund të ofrojë mbështetje. Projekt-propozimet mund të paraqiten nga pushteti vendor, OJQ lokale, etj. |
| Transparenca | CAO të lehtësojë organizimin e një takimi të EITI-it (Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse) në Marinëz, me pjesëmarrje më të gjerë të anëtarëve të komunitetit në këto takime. | Në Maj 2015 u mbajt një takim në Fier me grupin e punës të Çështjeve Sociale dhe të Investimeve, ku u prezantua informacion rreth EITI-it dhe taksave të paguara nga BPAL. Është kërkuar që një takim i tillë të organizohet në Marinëz në vitin 2016. |

Legjenda:

- “Statusi i çështjes” (1(PZ)) Proces zgjidhjeje; (2(NM)) Nën monitorim; (3(ÇZ)) Çështje e zgjidhur; (4(TA)) Transferuar për audit
- Lista 1/2: Lista 1: Çështje që janë të negociueshme midis komunitetit dhe kompanisë; Lista 2: Çështje për të cilat nevojitet përfshirja e aktorëve të tjerë në negociim (p.sh. pushteti vendor, institucione të tjera shtetërore);